



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ р./в.



Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 12/19), dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar për lëndën e formuar pas denoncimit nga parashtrues i njohur, në vazhdimin e seancës së 42-të të mbajtur me datë 14.12.2020 morri:

### VENDIM

**NDËRPRITET** procedura për lëndën me numër 12-3711/1 me datë 29.07.2019, formuar pas denoncimit nga parashtruesi ..... dorëzuar deri tek KSHPK.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim ë mëtutjeshëm në lëndën me numër 12-3711/1 me datë 29.07.2019, me arsyje që organet tjera kompetente në përputhje me kompetencat e tyre ligjore kanë vepruar dhe ndërmarrë veprime në drejtim të caktimit të gjendjes faktike dhe zgjidhjen e rastit konkret.

Lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi të dorëzohet Vendimi, me sqarimin.

Vendimi nga KSHPK, me sqarimin, në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e KSHPK në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

### Sqarim

Lënda me numër 12-3711/1 me datë 29.07.2019 e formuar pas denoncimit nga parashtruesi m-r Agron Konxheli dorëzuar deri tek KSHPK.

Në denoncim tregohet për akuza për dyshime të veprimeve joligjore nga ana e personave zyrtar në Ministrinë e punëve të jashtme – Drejtoria e çështjeve konzulare të Republikës së Maqedonisë së Veriut (atëherë Republika e Maqedonisë) përshkak të mosveprimit për Lutjen e dorëzuar për mbrojtje të ndërsjellë të investimeve të investuara në teritorin e Republikës së Shqipërisë, si investitor / i huaj, parashtruesi ..... për lëndën e protokoluar me numër K-1506-47/1.

Gjegjësisht, parashtruesi deri në MPJ dorëzoi kërkesë me shkrim – Lutje në periudhën prej 1995-1996, mirëpp prej atëherë, gjer më sot MPJ – Drejtoria për çështje konzulare nuk ka ndërmarrë asnjë lloj të veprimeve për kërkesën e dorëzuar për mbrojtje të investimeve të tij si investitor në teritorin e Republikës së Shqipërisë. Investimi i tij ka qenë në vitin 1991, gjegjësisht nënshkroi kontratë për shfrytëzim shumëvjeçar të objektit shoqëror-afarist me datë 05.08.1991 për periudhë prej 10 vitesh me të atëhershmen Ndërmarrje Tregëtare për ushqim social miratuar nga Ministria e atëhershme për tregëti të brendshme dhe turizëm.

Në ndërkohëpa marrë parasysh kontratën e nënshkruar për me qira dhe shfrytëzim në afat prej 10 vite me të drejtë për blerje, me datë 04.03.1993, dhënësi me qira dërgoi kërkesë,

menjëherë me datë 05.03.1993 që marrësi me qira menjëherë ta lëshon objektin afarist. Për këtë nëpërmjet policisë i është mbyllur objekti afarist – ëmbëltore dhe ka filluar golgota e marrësit me qira që ta dëshmon të drejtën e vet para gjykatave dhe organeve tjera kompetente në Republikën e Shqipërisë.

Gjykata e atëherëshme e Rrethit në Tiranë e rrefuzoi kërkesën për padi të dhënësit me qira dhe atëherë marrësi me qira filloj procedure për blerje të objektit afarist në përputhje me të drejtën e pranuar për pafajësi nga marrvëshja për me qira. Nga dokumentacioni i dorëzuar në shtojcë të denoncimit vërehet se ka filluar procedura dhe gjoja se objektin afarist të lëndës e ka blerë me datë 09.08.1994, mirëpo nuk është dorëzuar dokumentacion për shit-blerjes. Me shumë gjasa procedura ka qenë ndërprerë me vazhdimin e procedurës gjyqsore para Gjykatës së Apelit dhe asaj qytetare (atëherë gjykata e kasës), të cilët e pranojnë kërkesën për padi për dhënësit me qira i cili gjoja ka dorëzuar padi për shfuqizim të kontratës, e dorëzoi nën presion të të punësuarve nga Ndërmarrje tregtare për ushqim social, të cilën gjoja kan qenë aksionarë në këtë ndërmarrje dhe kan pjesë në prone.

Deri tek MPJ – Drejtoria për çështje konzulare dorëzoi ankesë se iu është kanosur investimi në teritorin e Republikës së Shqipërisë nga ana e personave zyrtar të organeve shtetërore në Republikën e Shqipërisë. Nga MPJ kërkoi mbrojtje të investimit të tij dhe kapitalit investues në pronë të patundshme.

Nga MPJ kërkoi në mënyrë diplomatike nga Agjensioni për privatizim pranë ..... në teritorin e Republikës së Shqipërisë që t’ia kthen kontratën për shitë-blerje për objektin afarist të lëndës, t’ia dorëzon në pronësi dhe kontroll objektin afarist të lëndës, me të gjitha makineritë, paisjet, mjetet, inventarin, artikuj ushqmor social, dhe të tjera në gjendje siç kan qenë deri me datë 30.06.1994, kjo është, në gjendje fillestare, gjegjësisht para mbylljes nga pronarit (pa vendim gjyqsor) dhe plumbim të objektit me plumbë shtetërore dhe numër.

Në denoncim theksohet se personat zyrtar në MPJ – Drejtoria për çështje konzulare e RM në atë kohë, është munduar për mbrojtje të investimit të tij, rregullisht e ka informuar në vitin 1995 dhe 1996, dhe pastaj nuk e ka lajmëruar ose lajmërimet e kan qenë paushale dhe jologjike. Ai ka vazhduar të dorëzon lutje deri ten MPJ edhe në vitet e ardhshme.

Parashtruesi i denoncimit për mbrojtje të të drejtave të tij tërhiqet nga Kontrata e firmosur ndërmjet qeverisë së Maqedonisë dhe qeverisë së Shqipërisë për nxitje dhe mbrojtje të ndërsjelltë të investimeve e cila është nënshkruar me 4 Dhjetor 1997 dhe është ratifikuar me ligjin për ratifikim me datë 10 Mars të viti 1998.

Me qëllim të caktimit të gjendje faktike dhe kontrollimit të akuzave në denoncim, KSHPK dërkoi Kërkesë për mbledhje të të dhënave dhe informacioneve me numër 12-1831/1 me datë 28.04.2020 deri në MPJ-Drejtoria për çështje konzulare me të cilën kërkohet të dërgon informacine në lidhje me mosveprimet konktrrete të lëndës së vulosur me numër K-1506-47/1, pastaj rivulosur me numër 85-2549/3 për të cilën personi ..... ka dorëzuar Lutje për mbrojtje të ndërsjelltë për investimet e investuara në teritorin e Republikës së Shqipërisë si investitor i huaj, fillimisht dorëzuar në vitin 1995, për atë se vallë në Drejtorinë për çështje konzulare është formuar lëndë pas dorëzimit të denoncimit – Lutje nga parashtruesi ..... dhe vallë nga ana e personave zyrtar në Drejtorinë është vepruar për lutjen e dorëzuar në drejtim të kontrollimit të akuzave dhe vallë a janë ndëmarrë hapa konktrrete për të njëjtën dhe cili është përfundimi nga veprimet.

Brenda afatit të caktuar me ligj është dorëzuar përgjigje nga MPJ - Drejtoria për çështje konzulare.

Nga vëzhgimi në dokumentacionin e mbledhur, KSHPK e caktoi gjendjen faktike vijuese:

Parashtruesi i denoncimit ..... dorëzoi kërkesë deri për përkrahje konzulare në Ministrinë për punë të jashtme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në gjysmën e dytë të viteve 90-ta. Nga ana e MPJ nëpërmjet Ambasadës së Republikës së Maqedonisë së Veriut në Tiranë dhe në përputhje të komunikimit diplomatik dhe praksës, kërkesa e tij së bashku me dokumentacionin e ofruar është bartur deri në institucionet kompetente në Republikën e Shqipërisë me kërkesë zbardhje të rastit, gjegjësisht gjetje e zgjidhje për rastin. Në lidhje me këtë, nga Ministria e Drejtësisë në Republikën e Shqipërisë, është marrë përgjigje se pas kontrollimit të bërë në regjistrat kompetet zyrtar, ..... nuk rezultoi si pronar i hapsirë afarite të lëndë, me çka si mundësi për zgjidhje të të drejtës së tij të pronës udhëzohet në organet gjyqësore të Republikës së Shqipërisë. Për përgjigjen e marru, Ministria për punë të jashtme në Republikën e Maqedonisë së Veriut e informoi me shkresë ....., duke treguar se rastin e tij mund ta zgjidh vetëm nëpërmjet gjyqit.

Ministria e punëve të jashtme në Republikën e Maqedonisë së Veriut për gjetjen e zgjidhjes adekuate për rastin e ....., çështjen e ngriti edhe në nivel më të lartë diplomatik, në konsultime konzulare ndërmjet dy shteteve. Si rezultat i kësaj, përsëri është marrur përgjigje se organet kompetente në Republikën e Shqipërisë nuk arritën t'i vërtetojnë akuzat e z. Konxhelit për uzurpim me dhunë të pronës së tij private në Tiranë dhe për këtë kontratë përsëri ..... është informuar me shkresë.

Përshkak se të gjitha rrugët diplomatike dhe mundësitë për akuzat e veta ishin shterrur, me çka nga ana e organeve shqiptare kompetente është dhënë përgjigje përfundimtare për gjetje të zgjidhjes, MPJ rastin e shpalli për të mbyllur, kurse palës i rekomandoi të ngriti procedurë adekuate para organeve gjyqësore të Republikës së Shqipërisë.

Në fillim të Teorit të viti 2019 ..... me shkresë u drejtua deri në Ministrinë për punë të jashtme të Republikës së Maqedonisë së Veriut me kërkesë për zgjidhje të rastit të tij. Në periudhën e mëtejshme pas disa bisedave telefonike me ..... me datë 18.10.2019 në hapsirat e MPJ është mbajtur takim ku ..... në mes tjerash, detajisht është informuar për kompetencat e MPJ për rastin e tij dhe se lënda e tij paraprake në vitin 2004 ishte mbyllur. I është tërhequr vërejtja se shkresa e tij e dorëzuar është tendencioze me numër të të pavërtetave dhe elemnete për shpifje, kurse kërkesat e vendosura janë jashta kompetencave diplomatike. Për shkak të kësaj shkresa i është kthyer në dorë, me lutje që e njëjta të rerefinohet dhe pastaj së bashku me dëshmitë për taksën konzulare të paguar dhe kopje të dokumentit për dëshmim të pronësisë ose kopje të dokumenteve gjyqësore nga procedura, të dorëzohen përsëri. Në lidhje me këtë, ..... informon se nuk posedon asnjë dokument për pronësi, dhe se në fillim të viteve të 90-ta nëpërmjet përfaqësuesit juridik në Tiranë është orvatur që ta kthen në pronësi të tij, mirëpo më vonë avokati është tërhequr nga rasti përshkak se nuk ka ngritur procedurë adekuate gjyqësore në Republikën e Shqipërisë.

Pas realizimit të mbledhjes ..... dorëzoi edhe dy shkresa me të cilat jo vetëm që kërkesa nuk është e precizuar deri në fund në përputhje me atë që është dakorduar në mbledhje, por në kërkesat e mëhershme (shkresa e parë) shtoi edhe kërkesë tjetër e cila nuk

është në kompetenca të MPJ, dhe njëherit kërkoi nga MPJ të formon komision të arbitrazhit në përputhje me nenin 8 nga Kontrata e RMV dhe RSH për nxitje dhe mbrojtje të ndërsjelltë të investimeve nga viti 1998 që të zgjidhet rasti i tij.

Përshkak të të theksuarës më lartë, me z. Konxheli është zhvilluar edhe një takim me çka i është treguar se rasti i tij nuk mund të zgjidhet në bazë të lëndës së Kontratës, kurse nga ana tjetër MPJ nuk është realizues i të njëjtës, por Qeveria gjegjësisht Ministria e ekonomisë.

Parashtrusit përsëri i është dhënë në dijeni se rasti i tij mund të zgjidhet vetëm nëpërmjet organe gjyqsore në Republikën e Shqipërisë, kurse MPJ për momentin mund vetëm të kërkon nga organet zyrtare kompetene shqiptare përgjigje në lidhje me atë që nuk i është dhënë Kontrata e shitë-blerjes për hapsirën afariste (sipas tij) pas bërjes së pagesës së plotë, në përputhje me shpalljes publike (sipas kopjeve nga mjetet e paguara), gjegjësisht të kërkohete mostër nga kontrata (nëse e ka). Për shkak të kësaj, edhe një herë ..... është lutur deri tek personat zyrtar në MPJ të precizon më mirë kërkesën dhe të dorëzon deri në MPJ së bashku me kopje nga taksa e paguar konzulare. Në këtë kërkesë të MPJ ..... gjer më sot nuk është përgjigjur me shkresë, kurse në bisedë telefonike informoi se lëndën do ta aktivizon nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë, si zbatues i Kontratës ndërmjet RMV dhe RSH për nxitje dhe mbrojtje të ndërsjelltë të investimeve nga viti 1998.

Duke pasë parasyhtë të gjithë të sipërshënuar, KSHPK konstatoi se në rastin konkret vepronjë organe tjera kompetente në përputhje me kompetencat ligjore dhe ndërmarrin veprime konkrete në drejtim të caktimit të gjendjes faktike dhe zgjidhjen e rastit konkret, për arsye që KSHPK përfundon se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për këtë lëndë dhe lënda të mbyllet dhe të arkivohet. Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Pas përfundimit të seancës së KSHPK

Punoi: m-r I.P.

Miratiu N.B., anëatr i KSHPK

KOMISIONI SHTETËROK PËR  
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT  
Kryetar: Biljana Ivanovska